



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 11, datë 27.02.2014**

**PËR**  
**LICENCIMIN E Z. GRAMOS YLLI SI VLERËSUES TË DËMEVE NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 9572, neni 14, pika 23, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të Ligjit nr. 9267, neni 89, pika 1, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, si dhe të VKM-së nr. 164, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Licencimin e Z. Gramos Ylli, në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin, *Vlerësues i dëmeve shëndetësore*, me afat 5 vjet, në këto grupe sigurimi të Jo-Jetës:
  - Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit;
  - Sigurime motorike.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Enkelelda SHEHI**